
RECENSIONE

**SHAQIR VUKAJ: "RUSIA DHE KOSOVA
(SHËNIME TË NJË DIPLOMATI)"**
Shtëpia botuese "Enriko Kuço", Tiranë 2007, 671 faqe

Dy fjalë për autorin

Autori i librit "Rusia dhe Kosova (*Shënime të një diplomati*)", Shaqir Vukaj, ka qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë në tri legjislatura të tij, ndërsa gjatë viteve 1992-1996 ka qenë dhe nënkryetar i këtij Kuvendi. Po kështu për një periudhë të caktuar kohe ka drejtuar Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Turizmit të Shqipërisë. Ndërsa në diplomacinë shqiptare ka dhënë kontribut për 16 vjet rresht: si ambasador i Shqipërisë në Bullgari, në Republikën Çeke dhe që nga viti i vlimeve të mëdha politike 1998 e deri më 2002, në Federatën Ruse.

Struktura e librit

Libri "Rusia dhe Kosova (*Shënime të një diplomati*)", është specifik si në aspektin strukturor ashtu edhe në atë përmbajtësor. Në fakt, kemi të bëjmë me një libër shumështrësor- shtresa këto në një relacion komplementar dhe organik midis tyre. Libri në vend të hyrjes ka tri vështrime analitike (f. 3-26) të tri personaliteteve politike e shkencore shqiptare, si: Rexhep Mejdani (*Në vend të parathënies*), Pëllumb Xhufi (*Kosova dhe Rusia*) dhe Hamit Boriçi (*Kosova në optikën ruse*).

Pjesës qendrore të këtij libri: Ditari për Kosovën 20 korrik 1998-30 shkurt 2002 (f. 159- 639), i paraprin një trajtim i thuktë i dimensionit historik të çështjes, përkatësisht i politikës ruse ndaj popullit shqiptar në përgjithësi dhe Kosovës në veçanti (f. 19-158). Ky kapitull i librit zërthehet përmes përmbajtjeve si: Rusia dhe Ballkani (f. 28-57); Federatë ballkanike apo perandori sllave (f. 57-70); Moska dhe çështja shqiptare në periudhën 1944-1948 (f. 82-122); Rusia dhe shpërbërja e Jugosllavisë (f. 123-131); Moska dhe Kosova (f. 132-159). "Ditari për Kosovën" ndiqet nga pjesa e librit që mban titullin "Ditari për zhvillimet në Maqedoni, 1 mars 2001-30 shkurt 2002 (f. 547-639). Dhe së fundi,

pjesa e “Ditarit” pasohet në mënyrë krejt organike me një përmyllje analitike të politikës ruse ndaj Kosovës brenda viteve 2002-2007.

Vendi i shqiptarëve në kontekstin ballkanik të politikës ruse (shek. XIX-1989)

Në pjesën e parë të librit, autori Shaqir Vukaj ka përcaktuar kontekstin ballkanik të politikës ruse dhe vendin e shqiptarëve në këtë kontekst përgjatë shekullit XIX-të deri në kohën e kthesave të mëdha, përkatësisht deri në vitin 1998. Nga analiza shkencore e bërë në këtë pjesë të librit, del qartë se politika ruse ndaj Ballkanit përcaktohej nga synimet ekspansioniste drejt deteve të ngrohtë- Mesdheut. Pasi që këto synime hasën në kundërshtimin e fuqishëm dhe të vazhdueshëm të Evropës Perëndimore, Rusia vuri në veprim planin “B”, i cili në thelb kishte pansllavizmin dhe ortodoksinë. Mbi bazën e kësaj ideologjie, carët rusë dhe rrethi i tyre, dhanë mbështetje dhe përkrahje të gjithanshme për popujt dhe shtetet ballkanike për çlirim dhe zgjerim territorial, në emër të etnisë sllave (malazezëve, serbëve, bullgarëve) po dhe në emër të fesë ortodokse (rumunëve, grekëve). Në fakt kjo ishte mënyra më e përshtatshme dhe më e lehtë që Rusia të siguronte prezencën e saj në pozitë strategjike të Evropës Juglindore. Natyrisht shqiptarët mbetën jashtë kësaj skeme dhe Lëvizja e tyre kombëtare u kundërshtua fuqishëm nga klientela ballkanike e Ruisë (fqinjët e shqiptarëve pa përjashtim). Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1912-1913), të cilat i detyruan shqiptarët që të jetojnë të ndarë duke lënë një pjesë të madhe të tyre jashtë Shqipërisë dhe nën regjimet nacionaliste të Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, ishin rezultat i bashkëveprimit të diplomacisë ruse me politikën e këtyre shteteve. Në këtë skemë antishqiptare u ndërthur dhe interesi i Francës së atëhershme, e cila tek sllavët shihte aleatët natyrorë të saj kundër Gjermanisë të bashkuar, të fuqizuar dhe ekspansioniste. Republika franceze nuk mund ta tejkalonte humbjen e turpshme të vitit 1871, kur Gjermania ia rrëmbeu Alzasin dhe Lorenën, dhe në zemër të saj (Versajë) u shpall formimi i Perandorisë Gjermane.

Ky libër pasqyron qartë se në periudhën e instalimit të sistemit komunist në Ballkan dhe Evropën Qendrore (1944-1947), shqiptarët (Shqipëria, Kosova etj.) u lanë në duar të Partisë Komuniste Jugosllave, deliri ekspansionist i së cilës e frikësonte edhe vetë Stalinin. Ky i fundit u ballafaqua me faktin se e përkëdhelura e tij Partia Komuniste Jugosllave, përkatësisht drejtuesit e saj kryesorë me Josip Broz Titon në krye, mund

ta fusnin BRSS-në në bela të mëdha me të gjithë, madje dhe me aleatët e luftës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britaninë e Madhe. Këtë delir ekspansionist të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Jugosllavisë, më së miri e ilustron takimi i delegacionit jugosllav i kryesuar nga Andrija Hembrang me Stalinin në prag të takimit në nivel të lartë të shteteve të Koalicioni Antifashist në Jaltë. Pala jugosllave kërkonte që BRSS-ja të angazhohej që Jugosllavisë t'i sigurohej aneksimi jo më pak se: i krahinës së Peçit në Hungari, i krahinës së Korushkës në Austri, i krahinës së Istrias me portet e Triestes dhe të Pulias në Itali, i krahinës së Timoshoarit në Rumani, i Maqedonisë greke dhe i Selanikut në Greqi. Ndërsa Bullgaria do të duhej të pranonte bashkimin me Jugosllavinë. Kërkesat megalomane të përsëritura në vazhdimësi nga ana jugosllave bënë që Stalini t'u bëjë me dije kamaradëve jugosllavë se kështu "ju do të jeni në pozita armiqësore me Rumaninë, Hungarinë, Greqinë dhe se po përgatiteni të luftoni me të gjithë botën" (f. 74). Ndërsa ministri i punëve të jashtme sovjetike Molotovi i "pyeste" jugosllavët "mos vallë ju mendoni se çdo qark duhet të ketë dalje në det?" (f. 74).

Por ajo çka përcaktoi përfundimisht marrëdhëniet e Moskës me Beogradin, ishte frika e Stalinit nga një Pol i Dytë që mund të krijonte J.B.Tito në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, e posaçërisht në Ballkan. Afrimi Jugosllavi-Bullgari, Jugosllavi-Shqipëri dhe Jugosllavi-republikat e tjera të Evropës Lindore, jashtë kontrollit dhe miratimit të Moskës, duke shkelur hierarkinë udhëheqëse të Bllokut komunist evropian që po formohej, e shqetësuan dhe irrituan Stalinin, i cili i dha një goditje asgjësuese pranisë së Partisë Komuniste Jugosllavisë në këtë bllok.

Libri "Rusia dhe Kosova (ditari i një diplomati)", në mënyrë plastike pasqyron edhe qëndrimin e udhëheqjes komuniste dhe shtetërore jugosllave (në vitet e para të pasluftës) ndaj "Çështjes së Kosovës"- si pjesë e çështjes kombëtare shqiptare, qëndrim ky tepër cinik e i cili mund të përmbliidhet në sa vijon: Kosova do të duhej të bashkohej me Shqipërinë, porse rrethanat e brendshme dhe të jashtme nuk lejonin një gjë të tillë. Por megjithatë, bashkimi shqiptar mund të ndodhë por brenda Jugosllavisë - pra nëse Shqipëria heq dorë nga pavarësia dhe shndërrohet në republikë të shtatë të federatës jugosllave. Ndërkaq, shkëputjen nga Blloku Komunist-Lindor (Informbyroja - 1948) dhe koketimi i tij me Perëndimin, Beogradi e shfrytëzoi për zbatimin e politikës të shtypjes së skajshme ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe vise të tjera shqiptare brenda Jugosllavisë. Në fakt, politika jugosllave e ndjekur dhe e zbatuar ndaj

shqiptarëve gjatë viteve 1944-1966 e sidomos ajo e viteve 1981-1999, dëshmon se vitet '60-'70 të shekullit të kaluar, kanë qenë vite të një sprapsje të pjesshme dhe të përkohshme të nacionalizmit serb, si rezultat i zhvillimeve politike në planin ndërkombëtar dhe i ambicies së Josip Broz-Titos-Jugosllavisë për liderizëm botëror (Lëvizja e të Përkohshmeve).

Korrelacioni Kosovë-Rusi

Pjesa e librit "Ditari për Kosovën", është një dëshmi-dokument për politikën ruse ndaj Kosovës, politikë, e cila është në harmoni të plotë me ekstremin nacionalist politik serb, apo siç e thekson vetë autori, Shaqir Vukaj: "rreth Kosovës çdo gjë shihej me sytë e Beogradit..." (f. 133). Nga ky ditar diplomatik del se konstanta e politikës ruse ndaj Kosovës karakterizohet nga kundërshtimi, minimizimi, kërcënimi... Kësaj politike antishqiptare të Kremlinit, mjerisht i bëjnë jehonë dhe madje e plotësojnë publicistika por dhe institucionet shkencore ruse. Politikanë, diplomatë, ushtarakë, publicistë, analistë, historianë, shkrimtarë e akademikë u përfshinë në kundërshtimin dhe parandalimin e pavarësisë së Kosovës. Bie fjala, historiania Jelena Guskova, në bashkëpunim me kolegë të institucioneve shkencore beogradase përgatiti dhe botoi librin dyvëllimësh "Istoriya Jugosllavenske krize 1990-2000", libër ky që u përhap paralelisht në Moskë-Beograd. Ky libër në krye të ballinës ka një emërtim shumë sugjestiv: DOKUMENT. Autorja-historiana J. Guskova, bën të vetat "tezat" stereotipike serbe lidhur me Kosovën si: "djep serb", "Jerusalem Serb", "Krahinë serbe e banuar me 90% shqiptarë", "plagë e hapur për Serbinë", "Kosova, plagë e hapur në ndërgjegjen nacionale serbe" etj. Ndërsa shqiptarët përcaktohen si: ardhacakë, terrorizues tradicionalë të popullsisë serbe në Kosovë, bashkëpunëtorë të nazifashizmit, kolonë, fundamentalistë, separatistë, ekstremistë islamikë, "shqiptari", "kosmetski shqiptari" etj. Ndërkaq, Josip Broz- Titoja dhe udhëheqja komuniste jugosllave në përgjithësi, akuzohet që "nuk bëri asgjë" për të "rimëkëmbur strukturën e mëparshme etnike në Kosovë". Madje shkohet aq larg sa që në sfond të "nacionalizmit shqiptar" vendoset Tirana-Shqipëria. Por megjithatë, Guskova me shokë nuk e çon këtë logjikë deri në fund si dikur (në prag të Luftës së Dytë Botërore) Ivo Andriçi me shokë, i cili e shihte të leverdisshëm eliminimin e Shqipërisë, goftë edhe në bashkëpunim të ngushtë me Italinë, sepse kështu pushonte

së ekzistuari “qendra e irredentizmit shqiptar”. Një të rame dy të vrame; në fakt, një të vrame: Kombi shqiptar.

Ndërkohë që ultranacionalizmi serb me eksponentin e tij Sllobodan Millosheviçin, nga teoricienë perëndimorë vlerësohet si fashizëm, nga publicistika dhe shkenca (pseudoshkenca) historiografike ruse, ky nacionalizëm cilësohet si “valë patriotizmi” në funksion të shpëtimit të Kosovës serbe nga shqiptarizimi i saj dhe “përpjekje për ndryshim të strukturës nacionale” të Kosovës. Duke i rënë kësaj gozhde, publicistika dhe në fakt pseudoshkenca ruse, kishte-ka për qëllim që të ndikojë në opinionin e brendshëm rus, në mënyrë që ai politikën ruse ndaj Kosovës ta perceptojë dhe ta vendosë në kontekstin e ligjësisë ndërkombëtare dhe ndreqjes së padrejtësive historike që “shqiptarët iu bënë serbëve”. Kjo frymë antishqiptare në Rusi, ka për qëllim t’i japë krahë forcave regresive serbe, të cilat Serbinë e mbajnë peng të programeve atavike kolonialiste dhe po e shkëpusin atë nga rrjedhat integruese evropiane, duke e shndërruar kështu në një klientelë të përhershme ruse.

Në këtë libër nuk heshtën zërat disonues që dëgjohej në botën ruse në relacion me këtë frymë antishqiptare, si ai i historianes Nina Smirnova, A. G. Zadohin, Grizunov e ndonjë tjetër. Përkundrazi, respekti i thellë ndaj tyre hetohet lehtë. Por mjerisht, numri i këtyre personaliteteve me integritet moral, njerëzor e kulturor, siç del nga ky libër, ishte tepër i vogël për të nxjerrë përfundimin për ekzistencën e një oponence reale ndaj politikës së Kremlinit për Kosovës.

Pjesa qendrore dhe kryesore e librit, Ditari për Kosovë, e që pasohet edhe me ngjarjet e mëdha e dramatike të shqiptarëve në Maqedoni dhe në Serbi (Luginën e Preshevës), qëndron larg asaj që të jetë një kronikë e thjeshtë që ndjek dhe përshkruan ngjarjet dita-ditës. Në fakt, kemi të bëjmë me një ditar tematik, sepse jo datat po titujt-përmbajtja është orientim themelor për lexuesin. Madje, autori Shaqir Vukaj si një vëzhgues, përzgjedhës e analizues i kujdesshëm, arrin që disa nga temat e trajtuara t’i ngrejë në nivelin e një analize të mirëfilltë shkencore, siç është bie fjala titulli: Nderim për prof. Nina Smirnovën (20 korrik 2001), me rastin e vdekjes së albanologes së shquar ruse. Kështu, ndër të tjera, shfrytëzimi si burim i këtij Ditari është shumë praktik.

Ky libër shtyn lexuesin në reflektime më të thelluara për të gjetur përgjigje për pyetjet, si: Ku qëndron interesi i Rusisë për një përkrahje kaq këmbëngulëse që i dha dhe po i jep Serbisë në Çështjen e Kosovës? Përse ajo qëndron aq fort në postulatet komprometuese politike të

shekullit XIX? A kemi të bëjmë me altruizmin për të afërmin apo thënë ndryshe solidaritetin atavik (vëlla i gjakut dhe fesë), apo në fakt para së gjithash kemi të bëjmë me instrumentalizimin e Serbisë për interesat globale të Ruisë. Kushdo që ndjek sado pak rezultatet e shkencave sociale dhe e lexon me vëmendje këtë libër, nuk ka se si mos të përcaktohet për opsionin e dytë. Kërcënimet e Moskës zyrtare për luftëra e destabilizime në shkallë rajonale e më gjerë nëse Kosova çlirohet nga vargonjtë kolonialë serbë; dhe së fundi, krahasimi i Kosovës me Palestinën, kriza e së cilës ende duket pa mbarim etj., në fakt flasin për synimet e saj që ta shndërrojë Serbinë në një instrument - apo fitil në “fuçinë e barutit”, “ për të fituar supremaci taktike në kuadrin e strategjisë së saj për rikthimin e influencës në botë” siç shkruante gazeta “The Washington Post” (13. 03 2007), të cilën e citon autori Shaqir Vukaj, (f. 652).

Leximi i vëmendshëm i këtij libri të qartëson se kur bëhet fjalë për Rusinë dhe Kosovën, nuk kemi të bëjmë vetëm me një “optikë ruse” apo relacion të thjeshtë Rusi-Kosovë. Në fakt, përmes Çështjes së Kosovës, bota ruse vetidentifikohet. Kjo do të thotë Kosova-çështja e saj, tashmë është një katalizator identifikues për botën ruse dhe jo vetëm për të. Qëndrimi ndaj Kosovës, i arsyeshëm apo me paragjykime, njerëzor apo me etje për territore, paqësor apo i dhunshëm, është identifikues edhe për gjithë botën. Ajo ç’ka po ndodh sot në Kosovë e ndaj Kosovës po bëhet pasqyrë ku po spikat shëmtia ruse (politika, publicistika, shkenca) pranë bukurisë rrëzëlluese të botës perëndimore. Pra, në fund të fundit kemi të bëjmë me një korrelacion Kosovë- Rusi. Apo siç konstaton autori i këtij libri “nipat e stërnipat e drejtuesve të Ruisë së sotme e të djeshme, do të turpërohen për ato që kanë bërë historikisht paraardhësit e tyre ndaj një populli të vogël që kurrë s’ia ka dashur të keqën askujt, pa lë më Ruisë së largët...”.

Libër “që lexohet me një frymë”

Ky libër, i cili “lexohet me një frymë”- siç konstaton presidenti Rexhep Mejdani, është dëshmi se deri ku mund të të çojë “indiferenca” ndaj të keqes-gjenocidit me të cilën u ballafaquan shqiptarët gjatë gjithë kohës së pushtimit serbo-jugosllav, e sidomos në vitet 1989-1999.

Vetëm kur lexohet ky libër, i cili shpalos në mënyrë aq të plotë qëndrimin e Kremlinit ndaj Kosovës dhe shqiptarëve në përgjithësi, qartësohet se ku gjente siguri politika destruktive e arkaike e

Milloseviqit dhe e bashkëpunëtorëve të tij. Po kështu, nuk ke se si mos të habitesh me deklaratat optimiste për qëndrimin rus ndaj Kosovës, të bëra jo një herë nga politikanët kosovarë.

Ditari diplomatik dhe pjesët e tjera të këtij libri, pasqyrojnë se politika ruse asnjëherë nuk lëvizi nga pozicionet e kundërshtimit të idesë së pavarësisë së Kosovës, madje as në kohën e shpërbërjes së BRSS-së, kur jashtë saj mbetën me miliona rusë.

Libri që kemi në dorë ofron materie të begatshme edhe për trajtimin e Çështjes së Kosovës nga diplomacia botërore. Pos kësaj, libri pasqyron dhe qëndrimin e vendosur, veprues dhe parimor për Kosovën, të kreut të shtetit shqiptar dhe posaçërisht të presidentit Rexhep Mejdani. Ky jo vetëm që nuk mori në “konsideratë” sugjerimet ruse të përcjella nëpërmjet zëvendëskryeministrit të Federatës Ruse A. Avdijejev, të bëra gjatë vizitës së tij në Tiranë më 21-22 qershor 1998, po pa finesa diplomatike deklaroi prerë se: “ Milloseviqi nuk e njuh gjuhën diplomatike, të kompromisit politik: ai njuh vetëm gjuhën e forcës, vetëm gjuhën e presionit me të gjitha variantet. Vetëm duke folur me këtë gjuhë me të, mund të shpëtojë rajoni”-çka dhe ndodhi.

Libri i diplomatit Shaqir Vukaj “Rusia dhe Kosova”, të cilin e karakterizon begatia e fakteve, objektiviteti, analiza e thellë po dhe aktualiteti, jep një pasqyrë jo vetëm të politikës ruse ndaj Kosovës, po dhe pozitës ndërkombëtare të Kosovës në një periudhë dramatike e vendimtare për ardhmërinë e saj. Si i tillë ky libër bëhet një burim i domosdoshëm jo vetëm për historianët, por dhe për politikanët, diplomatët, politikologët, analistët etj. Gjithashtu ky libër është më se i dobishëm edhe për lexuesin kureshtar e dashamir të dijes dhe fjalës së bukur.

Dhe së fundi, t’i kthemi fillimit. Ky libër i kushtohet Fehmi Lladrovci dhe të gjithë atyre që dhanë jetën për lirinë e Kosovës. Dhe kur përfundon së lexuari këtë libër, e kupton sa hije i ka dhe sa i natyrshëm është ky përkushtim.

Emine ARIFI-BAKALLI

